



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 33.

Prishtinë, më 03.12.2018, në orën 9:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu-Kodra, Armend Zemaj, Fikrim Damka, Ismajl Kurteshi, Visar Ymeri, Ismet Beqiri dhe Zenun Pajaziti.

Munguan: Donika-Kadaj-Bujupi, Fatmire Kollçaku, Milaim Zeka dhe Adem Hoxha.

Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu- Kodra, kryetare Komisionit

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligji nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja, konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Blerta Deliu-Kodra, tha se çështjet që rregullohen me këtë projektligj, mbeten kompetencë e brendshme e shteteve anëtare të BE-së dhe nuk janë të rregulluara në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së, andaj konstatoi se ky Projektligji me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj, mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Armend Zemaj, tha se vërejtja dhe sugjerimi im, është që duke e marrë për bazë në atë që kalon gjithmonë Republika e Kosovës, sidomos te fuqizimi i subjektivitetit të brendshëm dhe të jashtëm, akoma mbetet e pakuptimtë sepse në terminologjinë e përdorshme dhe juridike, termi “Republikë”, përjashtohet nga këto 3 ligje që i kemi në shqyrtim. Sido që të jetë, unë do të mbështes, por me qëllim apo pa qëllim, ne po rrëshqasim në disa elemente të cilat në aspektin kushtetues dhe juridik po paraqesin një lloj dobësimi të institucioneve kushtetuese, sidomos ato që janë vitale, siç janë komponenti i Forcave të Armatosura.

Kamë shpresuar që Komisioni funksional, do të rregullojë këto çështje dhe te tri këtyre projektligjeve do t’ju shtojë emërtimin “Republikë”, ashtu siç na takon dhe siç e kanë të gjitha vendet sovraane, ndërsa edhe arsyeshmëria të kalojmë në aspektin kushtetues, do të ishte pak më e lehtë, sepse vetvetiu ne siç duket pa qëllim, apo dikush me qëllim, po i ik kësaj terminologjie, e cila nuk e fuqizon ashtu siç po dëshirojmë të gjithë ne, Forcat e Armatosura të Kosovës.

Ismet Beqiri, tha se për ne është shumë e rëndësishme që kemi arritur në këtë fazë dhe pa dallim të asnjë subjekti politik, po vijmë në një moment, kur do t’i përkrahim dhe do t’i votojmë këto 3 projektligje.

Konsideroj që në këtë momentum të rëndësishëm për sigurinë e vendit, e meritojnë përkrahjen këto 3 projektligje, dhe së paku këtu, nuk kemi dallime për asnjë nuancë, të qenit pozitiv apo opozitiv dhe ashtu siç i kemi votuar në seancë gjatë shqyrtimit në parim, do ta bëjmë edhe tani.

Si anëtarë të komisionit përkatës, kemi punuar një kohë në grupet punuese, janë bërë analiza e konsultime nga Zyra Ligjore dhe me njerëzit kompetentë, por nuk dua të flas për diçka që nuk e kam mandatin dhe nuk është kompetencë imja. Nëse çështja e terminologjisë ngritët si çështje, sigurisht që në seancë do të jepet një arsyetim, edhe pse, unë mendoj që nuk kemi pse t’i ikim asnjëherë emërtimit të saktë, që e sqaron identitetin tonë të plotë shtetëror dhe kushtetues dhe nëse tani nuk mund të ndryshohet, në një të ardhme të afërt, mund të bëhet plotësimi i tij.

Blerta Deliu-Kodra, kryetare, tha se pajtohet me vërejtjet e parafolësve dhe Komisioni funksional është dashtë ta trajtojë, por sidoqoftë, ne do ta kryejmë pjesën tonë nga aspekti i përputhshmërisë së projektligjit me legjislacionin e BE-së, andaj ftoj anëtarët e Komisionit të deklarohen në lidhje me projektligjin.

Pas votimit kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja, tha se çështjet që rregullohen me këtë projektligj, mbeten kompetencë e brendshme e shteteve anëtare dhe nuk janë të rregulluara në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së.

Konstatoj, se ky Projektligji me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Pasi nuk pati diskutues të paraqitur, ajo ftoi anëtarët e Komisionit, që me votë të deklarohen për këtë Projektligj .

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë;

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Blerta Deliu-Kodra, kryetare, tha se çështjet që rregullohen me këtë projektligj, mbeten kompetencë e brendshme e shteteve anëtare dhe nuk janë të rregulluara në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së.

Prandaj, konstatoi se ky Projektligji me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Pasi nuk pati diskutues të paraqitur, ajo ftoi anëtarët e Komisionit që me votë të deklarohen për këtë Projektligj .

Pas votimit, kryetarja konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-056 për Këshillin prokurorial të Kosovës me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Blerta Deliu-Kodra, tha se çështjet që rregullohen me këtë projektligj, mbeten kompetencë e brendshme e shteteve anëtare dhe nuk janë të rregulluara me legjislacionin e BE-së.

Konstatoj se Projektligji nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend. Komisioni funksional nuk ka pasur ndonjë amendament në lidhje me projektligjin e lartpërmendur.

Pasi nuk pati diskutues të paraqitur, Deliu-Kodra, ftoi anëtarët e Komisionit që me votë të deklarohen për këtë Projektligj .

Pas votimit, Komisioni njëzëri nxori këtë;

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-056 për Këshillin prokurorial të Kosovës me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

6. Të ndryshme.

Pasi nuk pati të paraqitur për diskutim, Kryetarja e mbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 9:30.

**E përgatiti
Stafi mbështetës i Komisionit**

**Kryetarja e Komisionit,
Blerta Deliu- Kodra**
